

P.nr. 992/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – Departamenti i Përgjithshëm NË PEJË, gjyqtari Ahmet Rexhaj , me sekretaren juridike Lindmire Begolli , në lëndën penale kundër të pandehurit L.D nga P ,për vepër penale “ te sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së , sipas aktakuzës të PPK në Pejë, PP/ II .nr. 2017/17 të dt. 20.09.2017 duke vendosur në lidhje me kërkesën për dhënjën e urdhërit ndëshkimor me dt. 04.10.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/ II .2017/17 të dt. 20.09.2017 dhe kjo gjykatë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor jep URDHËR NDËSHKIMOR.

I pandehuri

1. L.D i lindur me ne S , ku dhe tani banon ne P rr pa nr , i biri i H dhe nënes B e gjinisë G , me prof. i pa pune , i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar , Shqiptar ,shtetas i Kosovës , mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për arsye se:

Me datën 12.08.2017 rreth orës 08.30 min ne Peje ,pikërisht ne furrën e bukës “ Prizren “ ne rr Papa Klimenti duke përdor forcën ,me dashje ka sulmuar të dëmtuarin G M nga P , në atë menyre qe përdërisa i dëmtuari ishte ne furrën e bukës i pandehuri i ofrohet duke i thënë “ pse po qeshë” dëmtuari i përgjigjet se jam duke qeshur me XH D ku i pandehuri i revoltuar e kap te dëmtuarin me dy duart për fyti , duke ja tërhequr vrejtnjen qe mos te qeshe ,

-me çka ka kryer veprën penale “ të sulmit nga neni 187 par 1 te KPRK-së

Andaj gjykata konform nenit 41.42.43.46 dhe nenit 187 par 1 të KPK-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehuri L. D i përcakton dënimin me gjobë në lartësi prej 300(treqinde) € , të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit.

Nëse i pandehurit dënimin e përcaktuar nuk e paguan në afatin e caktuar , dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgu - 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (20) njëzet euro, si dhe 30(tridhjet) euro ,në emër te taksës për kompensimin e viktimave ,konform nenit 39 paragrafi 3 nen paragrafin 3.1 te ligjit 05/-L-036 në fatin prej 8 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontestin civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Pejë –Departamenti për krime te përgjithshme , kundër të pandehurit L D nga Peja , ka ngritur aktakuzë PP-/II-nr. 2017/2017 te dt. 20.09.2017 për vepër penale “ të sulmit nga neni 187 par 1 te KPRK-së.

Konform nenit 493 të KPRK-së , Prokuroria Themelore në Pejë, pas ngritjes së aktakuzës kërkuar që gjykata pa mbajtur shqyrtim fillestar të jep urdhër ndëshkimor me të cilin te pandehurit ti shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPRK gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPRK dhe pa e mbajtur shqyrtimin fillestar vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokuroria Themelore në Pejë, për dhënjen e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptohet ndaj të pandehurit dënimi me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura shkresave të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata e vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 73 të KPK ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç rast si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi të dhënat se i pandehuri më parë nuk kanë qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale. Rrethana rënduese për të pandehurin për momentin nuk kanë gjetur, prandaj , gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të aktgjykimit duke e bindur se ky dënim është adekuat me shkallën dhe rrezikshmerinë e veprës penale por edhe me shkallën e përgjegjësisë penale duke qenë e bindur se edhe me këtë dënim , ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK.

Vendimi lidhur me kërkesën pronësore-juridike është marrë konform nenit 463 të KPPK .

GJYKATA THEMELORE NË PEJË,DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM
P.nr 992/17

Sekretare Juridike
Lindmire Begolli

G j y q t a r i,
Ahmet Rexhaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri
Ka të drejtë të ushtrojë kundërshtim
në afat prej 8 ditësh, të njëjtës gjykatë.